



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 136, Datë 07.06.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “INFO-TELECOM” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 07.06.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 87/5 prot., datë 04.06.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “INFO-Telecom” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 713 prot., datë 02.06.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “INFO-Telecom” sh.p.k., rezulton se subjekti ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar kryesisht kërkesat e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, Rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar, si më poshtë:
  - **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**, neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, plotësuar.
  - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor**, neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe “e”, plotësuar.
  - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal**, neni 9, pika 3, gërmat “b”, “c” dhe “d”, plotësuar.
  - **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike**, neni 9, pika 4.8, gërmat “a” dhe “c”, plotësuar.

- Dokumentacioni që mbetet ende pa u plotësuar tërësisht konsiston në:
  - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal**, neni 9, pika 3, gërma “a”, Vërtetim për shlyerjen e Tatim – Taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime).  
Shoqëria ka depozituar vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve tatimore, por në zbatim të kërkesave të kësaj pike të Rregullores, duhet të depozitohet në ERE edhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
  - **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike**, neni 9, pika 4.8, gërma “b”, Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.  
Shoqëria duhet të specifikojë kapitalin që vë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet shoqëria që ta depozitohet atë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**